

Letër familjes

I dashur student, të dashur familjarë,


Shumë lojra shtëpie mbështeten në fatin ose probabilitetin. Në kapitullin e ardhshëm do të studiojmë disa elemente bazë të probabilitetit. Do të fillojmë duke hetuar çfarë ndodh kur nxjerrim zare nga një qese. Për shembull, po të ketë në qese 6 rruzuj të gjelbër dhe 4 rruzuj të verdhë, mund të duam t'iu përgjigjemi pyetjeve të tilla si:

- Po të nxjerrim nga qesja një rruzull çfarëdo, i çfarë ngjyre ka më shumë të ngjarë të jetë?
- Sa janë gjasat që të nxjerrim një rruzull të gjelbër?
- Ta zëmë se nxjerrim një rruzull të verdhë, e futim në xhep, pastaj duam të nxjerrim një rruzull tjetër. Sa janë gjasat që ky tjetri të jetë i gjelbër?

Do ta përdorim probabilitetin për të kontrolluar nëse lojrat e fatit janë të paanshme. Gjithashtu do të luajmë një lojë që e përdor probabilitetin për të hartuar një strategji fitimtare.

Probabiliteti përdoret rëndom edhe në ngjërimit (kampionaturën) statistikor(e). Gjatë ngjërimit statistikor, zgjedhim rastësisht një grup të vogël dhe pastaj e përdorim këtë grup për të nxjerrë përfundime në lidhje me krejt popullatën. A mund të përmendni anketa ose statistika që keni parë, të cilat janë mbështetur në ngjërimit statistikor? A besoni se kjo është mënyrë e paanshme dhe e përpiktë për të nxjerrë përfundime në lidhje me një popullatë të madhe?

Pavarësisht nga përdorimi që u bëjmë, probabilitetet mund t'i gjejmë vetëm në rast se kemi të dhëna. Do të shohim dhe analizojmë mënyra të ndryshme të paraqitjes së të dhënave, si për shembull diagramet Box-and-Whisker. Pastaj do të shohim se kur është më e përshtatshme për t'i përdorur këto mënyra.



Fjalor Disa terma të rinj që do të përdoren në këtë kapitull:

popullatë
kuartil

mostër përfaqësuese
mostër

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Mund ta studioni edhe ju probabilitetin me fëmijën, duke luajtur me të lojra të ndryshme fati. Fëmija mund t'ju mësojë lojrat që kemi luajtur në klasë; por ka edhe lojra të tjera, si për shembull me letra, kur është mirë të merret me mend se çfarë letre ka gjasë të tërhiqet nga toka. Mund të flisni edhe për probabilitetin në jetën e përditshme, si për shembull sa gjasë ka që të bjerë shi, etj.